



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna nga neni 63.4 dhe neni 29.4 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Aktgjykim e Gjykatës Kushtetuese në rastin Nr. K095/20, **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** me datë 23.11.2021 merr këtë:

V E N D I M

Për zëvendësim të kandidatit të subjektit politik Srpska Lista për Kuvend Komunal në Komunën e Zveçanit

- I. Miratohet rekomandimi i Zyrës për zëvendësim të kandidatit të subjektit politik Srpska Lista, **Ivan Todosijević** me kandidatin e radhës me më së shumti vota **Marko Stefanović**.
- II. Kandidati zëvendësohet për Kuvendin Komunal në Komunën e Zveçanit.
- III. Zyra obligohet që të njoftoj kandidatin subjektin politike Srpska Lista dhe institucionet relevante për marrjen e këtij Vendimi.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim (Zyra) në përputhje me obligimet që dalin nga neni 29 pika q) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, më 23 gusht 2021, në lidhje me z. Ivan Todosijević, ka pranuar shkresë nga KGJK që nuk ka ndonjë vepër penale të formës së prerë. Ai, po ashtu, në seksionin B të formularit të kandidatit e ka cekur që kandidatura e tij nuk është në kundërshtim me Ligjin, e rrjedhimisht Zyra ka rekomanduar certifikimin e tij. Me datë 19 nëntor 2021, pas pranimit të informatës që Todosijević është i dënuar me vepër penale të formës së prerë, Zyra ka bërë edhe një verifikim në KGJK dhe në datën e njëjtë është pranuar informata që z. Todosijević është i dënuar me Aktgjykim të formës së prerë PS 20/2019 të datës 24.06.2021 që e bën kandidaturën e tij për Zgjedhjet Lokale 2021 në kundërshtim dhe të pavlefshëm në raport me Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Po ashtu, Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese në Rastin Nr. K095/20, ndër të tjera konstaton që fitimi i ulëses në mënyrë kundërligjore e bën të pavlefshëm mandatin e fituar. Prandaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi, Kryesues

